

Poesia Aracne

35

Edmond Çali

KUR VDES E DASHURA



Copyright © MMX
Edmond Çali

Copyright © MMX
ARACNE editrice S.r.l.

www.aracneeditrice.it
info@aracneeditrice.it

via Raffaele Garofalo, 133/A-B
00173 Roma
(06) 93781065

ISBN 978-88-548-3429-3

*I diritti di traduzione, di memorizzazione elettronica,
di riproduzione e di adattamento anche parziale,
con qualsiasi mezzo, sono riservati per tutti i Paesi.*

*Non sono assolutamente consentite le fotocopie
senza il permesso scritto dell'Editore.*

I edizione: agosto 2010

**Nuk vdes dashuria,
edhe nëse ndodh të shuhet e dashura...**

- mbresë nga poezia e Edmond Çalit -

Studiuesi dhe kritiku i letërsisë shqipe, dr. Edmond Çali, pedagog në Universitetin Oriental të Napolit, është dhe poet. Poezia e tij shfaqet rrallë, por me gjakimin që ajo të xixëllijë si diamantet në një si kadife të errët ndjesish.

Duke patur kultin e fjalës, teksa kërkon nga mjeshtrit e saj gjithshmërinë semantike, kuptim, ndjeshmëri, muzikë dhe vizion, po kështu edhe fjalët e veta i aktivizon me misionin që të përçojnë dhëmbjen dhe gëzimin e tij, atë që ai e emërton dashuri.

Ndërkaq kësaj *credo*-je ai i shton kursyeshëm, mbase më shumë nga ç'duron një poezi, detaje të një përditëshmërie të zhveshur, të mbetur vetëm me sublimen e saj, kur fjalët aftësohen për të qenë vargje, mundësisht në fillimin e inkandeshencës së tyre.

*Po të shkruaj
nga maja e botës
ku çmenduria
nuk më lë kurrë të lirë.*

Kjo poezi, me një shkurtësi ungaretiene, do të thosha se e jep më mirë se edhe vetë i gjithë opuskoli poetik gjendjen dhe mosgjendjen e poetit, vendin, kudo e asgjëkund, kohën apo moskohën, misionin dhe antimisionin që mision është gjithsesi, fatin, të shkruarit në majën e botës, në Olimpin e saj, ku çmenduria, e kujt, e pjesshme apo gjenerale, nuk na lë të lirë, se liria qënka dhe mënçuri. Do të jemi të lirë, aq sa do të jemi të ditur.

Më i lirë se kudo mbase poeti është tek dashuria e tij, i çliruar dhe nga liria e vet, ku shndërrohet në vetvete duke iu kushtuar asaj që do, i kuptuar ose jo, madje dhe nëse nuk i kthehet kjo dashuri, mjafton që ajo është brenda tij dhe e turbullon për të bërë poetin, që e qetëson për të ndjerë poetin, për t'u bërë *ëndërr*, për t'u bërë *fjalë*, për t'u bërë biografi njeriu.

Duke njohur nga jeta e autorit të këtij libri, unë që besoj se kur jeta bëhet poezi, dhe poezia mund të bëhet jetë, dua të tregoj

këtu se ka pak kohë, ditë, shekuj, çaste, njëlloj janë, që e dashura e tij u shua nga një sëmundje e rëndë dhe e pashërueshme në Londër. Poezia e tij është *ajo*, me frikën e ikjes, me parandjenja të fshehta, me ngazëllimin e të qenit bashkë. Dhe tani që *ajo* s'është, poezia bëhet arkëmorti i saj i kristaltë, me qirinjtë e metaforave përreth. Por dhe më shumë se aq, janë psherëtimat, shëtitjet, lotët, stinët, mbi të gjitha fjalët.

Dhe unë të harroj në poezitë e mia.

Kështu e shpreh ai të pa harrueshmen. Vdekja dhe jeta dhe ajo që është mes tyre, mbi të dyja, që i ndan, që i bashkon, që u jep kuptimin më të lartë, dashuria, janë dhe mbeten brenda fjalëve: *unë ndjek nga pas/fjalët që s'më thua*. Pra, të shkosh në një Eden heshtjeje, se *Ne jemi fjalë/që duam njëri tjetrin*. Ja, pra, qëllimi i njerëzve dhe i poezisë së tyre, i gjithë krijimtarisë artistike. Të duhemi se ne jemi dhe ajo që themi.

Edhe kur vdes e dashura, nuk vdes dashuria.

Vdekja, duke u futur mizorisht dhe pa mëshirë në mes, me një xheloz të verbër, nuk arrin ta ndërpresë, por përkundrazi, të jep dhe mundësinë e tejkalimit të kësaj prove mortore.

Dua të puth dhe fjalët e tua, thotë poeti, thjesht, me një befasi mahnitëse. Fjalët mbeten, të shkruara, të pashkruara, të thëna, në ajër, në kujtesën e gjithçkaje, të pathëna, në heshtjen folëse dhe poezia janë buzët e kësaj puthjeje. E dëshiruar nga të gjithë. Me një pakuptim të kuptuar më mirë se kurrë.

Pasmesnate, Romë, 19. 06. 2010

Visar ZHITI

**Non muore l'amore,
anche se succede che si spegne l'amata**
-impressioni dalla poesia di Edmond Çali-

E' anche poeta lo studioso e critico della letteratura albanese, il dr. Edmond Çali, lettore all'Università "L'Orientale" di Napoli. La sua poesia si manifesta raramente, ma con la brama di brillare come i diamanti su una scura superficie vellutata di sentimenti.

Avendo il culto della parola, se pretende dai maestri della parola totalità semantica, significato, sensibilità, musica e visione, allo stesso modo attiva le sue parole con la missione di dover trasmettere il suo dolore e la sua gioia, quello che lui denomina amore.

In modo parsimonioso nel frattempo aggiunge a questo *credo*, forse più di quello che sopporta una poesia, dettagli di un quotidiano spoglio, rimasto solo con il suo sublime, quando le parole sono in grado di essere versi, possibilmente all'inizio della loro incandescenza.

*Ti sto scrivendo
Dalla cima del mondo
Dove la pazzia
Non mi lascia mai libero.*

Questa poesia, di una brevità ungarettiana, direi che rende meglio di tutto l'opuscolo poetico lo stato ed il non stato del poeta, il luogo, ovunque e da nessuna parte, il tempo ed il non tempo, la missione e l'antimissione che, comunque sia, è una missione, il destino, lo scrivere dalla cima del mondo, dal suo Olimpo, dove la pazzia, di chi, parziale o generale, non ci lascia liberi, perché la libertà sarebbe anche intelligenza. Saremo tanto liberi, quanto intelligenti.

Nel suo amore forse il poeta è più libero di qualsiasi altro posto, liberato anche della libertà, dove si trasforma in se stesso dedicandosi a chi ama, compreso o non, anzi sebbene questo amore non gli venga ricambiato, basta che sia dentro di lui da turbarlo per fare il poeta, che lo calmi per sentire il poeta, per

diventare *sogno*, per diventare *parola*, per diventare biografia umana.

Apprendendo dalla vita dell'autore di questo libro, io che credo che quando la vita diventa poesia, anche la poesia può diventare vita, voglio raccontare qui che poco tempo fa, giorni, attimi, sono la stessa cosa, che la sua amata si è spenta a causa di una grave e incurabile malattia a Londra. La sua poesia è *lei*, con la paura dell'andare via, con segreti presentimenti, con la gioia dell'essere insieme. Ed ora che *lei* non n'è più, la poesia diventa la sua bara di cristallo, con le candele delle metafore attorno.

Ma più di questo, sono i sospiri, le passeggiate, le lacrime, le stagioni, soprattutto le parole.

Ed io ti dimentico nelle mie poesie.

Così esprime lui l'indimenticabile. La vita e la morte e quello che c'è tra di loro, sopra tutte e due, che le unisce, che dà loro il significato più alto, l'amore, sono e rimangono dentro le parole: *io inseguo / le parole che non mi dici*. Dunque, andare in un Eden di silenzio, perché *Noi siamo parole/ che ci amiamo*. Ecco, dunque, lo scopo degli uomini e della loro poesia, di tutta la creatività artistica. Amarci perché noi siamo anche quello che diciamo.

Anche quando muore l'amata, non muore l'amore.

La morte, entrando in mezzo in modo violento e spietato, con una cieca gelosia, non riesce ad interrompere, anzi al contrario, ti dà anche la possibilità del superamento di questa prova funebre.

Voglio baciare anche le tue parole, dice il poeta, in modo semplice, sorprendendoci in modo stupefacente. Le parole rimangono, scritte, non scritte, dette, nell'aria, nel ricordo di ogni cosa, non dette, nel silenzio che parla e la poesia è le labbra di questo bacio. Desiderato da tutti. Con un non significato compreso più che mai.

Dopo mezzanotte, Roma, 19.06.2010

Visar ZHITI

kur vdes e dashura

**quando muore
l'amata**

Për Nadian

Lei va.
La vita e io
 legati
 solo
 dal mio desiderio
 di sognarla tornare.
Da me.

[Edmond Çali, Poesia senza titolo n. 25]

poezi për atë dhe për të tjerat

Per Nadia

Lei va.
La vita e io
 legati
 solo
 dal mio desiderio
 di sognarla tornare.
Da me.

[Edmond Çali, Poesia senza titolo n. 25]

poesie per lei e per le altre

Një ëndërr e gjatë me ty.
Të mbaj nëpër shkallë.
Një ëndërr e gjatë me ty.
Dhe kaq shumë fjalë.
Një ëndërr e gjatë me ty.
Unë të mbaj në krahë.
Një ëndërr e gjatë me ty.
Nuk thua asnjë fjalë.
Një ëndërr e gjatë me ty.
Për ku vrapoj vallë?
Një ëndërr e gjatë me ty.
Dhe të puth në ballë.
Një ëndërr e gjatë me ty.
Ti me fustan të hollë.
Dikush komenton.
Ti e palos ngadalë.
Dikush kërkon tri kukulla.
Dikush më thotë tri fjalë.
Unë të shtrëngoj fort.
Dhe të ngre në krahë.
Një ëndërr e gjatë me ty.
Unë jam me ty.
Dua të jem me ty.
Të të them një fjalë.
Një ëndërr e gjatë me ty.
Gjithmonë pranë meje.
Gishtat janë të tutë.
Përkëdhelin lehtë.
Përkëdhelin ëmbël.
Përkëdhelin buzët.
Përkëdhelin flokët.
Përkëdhelin sytë.
Dhe të shkretat fjalë.
Një ëndërr për mua.
Një ëndërr e gjatë me ty.
Ah, ... ti me ato fjalë!
Një ëndërr e gjatë me ty.

Un sogno lungo con te.
Ti tengo per le scale.
Un sogno lungo con te.
E così tante parole.
Un sogno lungo con te.
Io ti tengo in braccio.
Un sogno lungo con te.
Non dici nessuna parola.
Un sogno lungo con te.
Dove corro mai?
Un sogno lungo con te.
E ti bacio sulla fronte.
Un sogno lungo con te.
Tu con un vestito sottile.
Qualcuno commenta.
Tu lo pieghi piano.
Qualcuno cerca tre bambole.
Qualcuno mi dice tre parole.
Io ti stringo forte.
E ti alzo in braccio.
Un sogno lungo con te.
Io sono con te.
Voglio essere con te.
Dirti una parola.
Un sogno lungo con te.
Sempre vicino a me.
Le dita sono le tue.
Accarezzano piano.
Accarezzano dolcemente.
Accarezzano le labbra.
Accarezzano i capelli.
Accarezzano gli occhi.
E le povere parole.
Un sogno per me.
Un sogno lungo con te.
Ah, ... tu con quelle parole!
Un sogno lungo con te.

Më mbaje aq pranë.
Largoheshe nga unë.
Dhe futeshe në gjoksin tim.
Duke mbyllur sytë.
Duke thënë një fjalë.
Duke thënë një emër.
Është emri im...
Unë bëhem ëndërr.
Unë bëhem fjalë.

[9.1.2005]

Mi tenevi così vicino.
Ti allontanavi da me.
Ed entravi nel mio petto.
Chiudendo gli occhi.
Dicendo una parola.
Dicendo un nome.
E' il mio nome...
Io divento sogno.
Io divento parole.